



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| | | | |
|--|------------|-------------|---------|
| Prindar - Propozim / Titulli: 01-03-2023 | | | |
| Nr. i organit | Nu. i broj | Sht. i q. s | Vlera |
| Ora. broj | | Prilog | Madhësi |
| 01-110/05-163 | | | |



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 36, paragrafi 36.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 28.02.2023, merr këtë:

V E N D I M

për aprovimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë 2023-2026

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton Planin e Integritetit për Komunën e Vitisë 2023-2026.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Planin e Integritetit për Komunën e Vitisë 2023-2026, me numër të protokollit 02-300/02-127, i datës 15.02.2023.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi për Planin e Integritetit 2023-2026 do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës së Vitisë, drejtorit të Komunës së Vitisë

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi për aprovimin e planit të integritetit 2021-2023, me numër të protokollit 01-110/05-262, i datës 28.04.2021.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit të Komunës;
2. Drejtorive Komunale; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

15-07-2023

| | | | |
|---------------|---------------|---------------|---------------|
| Org. Qendrore | Org. Qendrore | Org. Qendrore | Org. Qendrore |
| Org. Qendrore | Org. Qendrore | Org. Qendrore | Org. Qendrore |

02-300/07-127

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitina

DRAFT PLANI PËR INTEGRITET 2023 - 2026

KOMUNA E VITISË

Shkurt 2023, Viti

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| 1. Hyrja | 3 |
| 2. Deklarata për Integritet | 4 |
| 3. Parimet e menaxhimit të Integritetit | 6 |
| 3.1 Lidershipi | 6 |
| 3.2 Përfshirja e personelit | 6 |
| 3.3 Qasja sistemore | 7 |
| 4. Objektivat e Planit të Integritetit | 7 |
| 5. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit | 8 |
| 5.1 Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit | 8 |
| 5.1 Metodologjia e vlerësimit të rrezikut | 9 |
| 7.1.1 Matrica vlerësimit të rrezikut | 9 |
| 7.1.2 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut | 10 |
| 6. Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi | 11 |
| 7. Fushat e rrezikut | 14 |
| 7.1 Fushat e përgjithshme të Rrezikut | 14 |
| 7.1.1 Drejtimi dhe menaxhimi | 14 |
| 7.1.2 Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve | 14 |
| 7.1.3 Planifikimi dhe menaxhimi financiar | 14 |
| 7.1.4 Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve | 14 |
| 7.2 Fushat e veçanta të rrezikut | 14 |
| 7.2.1 Auditimi i Brendshëm | 14 |
| 7.2.2 Prokurimi publik | 14 |
| 7.2.3 Zhvillimi ekonomik lokal | 14 |
| 7.2.4 Planifikimi urban dhe rural | 14 |
| 7.2.5 Standardet e ndërtimit dhe kontrolli | 14 |
| 7.2.6 Inspektimet | 14 |
| 7.2.7 Arsimi Publik | 14 |
| 7.2.8 Shëndeti publik | 14 |
| 7.2.9 Licencimi i shërbimeve | 14 |
| 7.2.10 Mirëmbajtja e rrugëve dhe e parqeve | 14 |

1. Hyrja

Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe “Strategjinë Shtetërore Kundër Korrupsionit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të zhvillojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Komuna e Vitisw, harton dhe miraton Planin e Integritetit për periudhën 2023 -2026.

Plani i integritetit është një mjet për vendosjen dhe verifikimin e integritetit të organizatës dhe është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë së një organizate dhe ekspozimin e saj ndaj praktikave jo etike dhe të korrupsionit. Plani është dokument operativ, që ofron masa të mbështetura tek rreziku për të arritur objektivat e integritetit të komunës. Plani rithekson përkushtimin e komunës për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve efikase, transparente dhe të orientuar kah klienti. Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të komunës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

Plani i integritetit mundëson:

- Identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një organizate individuale;
- Vlerësimin e çfarëdo lloj rreziku që mund të paraqes rrezik për shfaqjen e korrupsionit për një organizatë individuale; dhe
- Përcaktimin e masave për të zvogëluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit.

Plani i Integritetit pritet të kontribuojë në mënyrë domethënëse në:

- Rritjen e mundësive që Komuna të arrijë objektivat e saja organizative duke vënë përpara një menaxhim pro-aktiv të rrezikut të integritetit. Kjo do të përmirësojë rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe do të zvogëlojë/eliminohet mundësitë për korrupsion.
- Përqendrimin tek prioritetet, në bazë të identifikimit dhe vlerësimit të rrezikut që do ta ndihmojnë komunën të shpërndajë në mënyrë efektive burimet e disponueshme kundër korrupsionit në mënyrë që të shfrytëzohen në mënyrën më mirë të mundshme;

- Përmirësimin e kontrolleve operacionale ndaj shkeljeve të integritetit që do të rrisin efektivitetin, efikasitetin dhe transparencën e të gjitha proceseve, përfshirë ofrimin e shërbimeve;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet përkatëse ligjore dhe procedurale;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm të favorshëm kundër korrupsion përmes trajnimit të synuar dhe ndërgjegjësimit, si dhe duke inkurajuar një bashkëpronësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të planeve të integritetit;
- Rritjen e mëtejshme të besimit të palëve të brendshme dhe të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstrohet nga Komuna.

Me zbatimin e këtij Plani, komuna do të jetë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të përmirësuara për publikun dhe rritje të kënaqshme nga ana e palëve të interesuara. Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga komuna. Prosesi ka përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të organizatës në rastet e shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre duke marrë parasysh dëmet materiale dhe jo materiale që shkaktojnë shkeljet përkatëse potenciale dhe gjasat që ngjarje të tilla mund të ndodhin duke parë rezistencën aktuale organizative të vërtetuar në rregulloret, procedurat, kodet, praktikat dhe përfshirjen e stafit.

2. Deklarata për Integritet

Zotohemi që Komuna e Vitisë me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin duhet të zhvillojmë më tej kapacitetet e Komunës dhe personelit tonë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha sfidave që kanë të bëjnë me integritetin, si dhe për të menaxhuar në mënyrë adekuate rreziqet e shumta e të ndryshme të integritetit me të cilat ne ballafaqohemi.

Me plan të integritetit, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standarde, parimet dhe objektiva në parandalimin e korrupsionit dhe sjelljeve tjera të paligjshme dhe joprofessionale. Duke identifikuar rreziqet, planifikimin dhe zbatimin e masave adekuate, ne forcojmë integritetin dhe kulturën kundër-korrupsion në punën e organeve të administratës komunale. Përmes planit të integritetit, ne eliminojmë shkaqet e korrupsionit të cilat mundësojnë forcimin e sundimit të ligjit dhe besimin e qytetarëve.

Ne e kuptojmë se, që të jemi të suksesshëm, menaxhimi i rrezikut të integritetit nuk duhet të jetë një ushtrim i vetëm, por të jetë një proces i vazhdueshëm që përkrah zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit. Andaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e planifikuara, por edhe të bëjmë përpjekje për të intezruar menaxhimin e rrezikut ndaj integritetit në kulturën organizative të Komunës në mënyrë të qëndrueshme. Të gjithë ne jemi përgjegjës për parandalimin e etikës, zbulimin me kohë dhe hetimin e korrupsionit, mashtrimit apo çdo shkeljeje tjetër të integritetit në komunë.

Integriteti është zgjedhja, si individë, si organizatë dhe si institucion publik, që përtëqësojmë interesat e qytetarëve, që vazhdimisht t'i përmbahemi etikës dhe standardeve profesionale dhe të veprojmë sipas parimeve demokratike, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi,

Andaj, ne besojmë që ky plan i integritetit do të jetë një ndihmesë në luftën kundër korrupsionit, në krijimin e një kulture organizative të punës dhe respektimit të kodit etik, në mënyrë që qytetarëve t'u kthehet besimi në punën e Komunës së Vitisë dhe shprehim gatishmërinë dhe përkushtimin e duhur për të gjitha përpjekjet për të fuqizuar dhe përmirësuar vazhdimisht sistemin e menaxhimit të integritetit brenda Komunës,

Kryetari i Komunës

3. Parimet e menaxhimit të Integritetit

3.1 Lidershípi

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshme të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit. Është shumë e rëndësishme që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm në mënyrë që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjitha palët e interesit, të jashtme dhe të brendshme.

3.2 Përfshirja e personelit

Është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e secilit punëtor në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon

edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i jashtëm dhe i brendshëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

3.3 Qasja sistemore

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kërkohet nga Komuna që të kushtojnë vëmendje të gjitha komponentëve të sistemit dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvarësinë ndërmjet tyre.

4. Objektivat e Planit të Integritetit

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe të rëndisë përpjekjet dhe burimet për të zvogëluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike në komunë.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një platforme ku të gjithë individët dhe njësitë në komunë si dhe qytetarët mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të administratës komunale.
- Krijimi i vetëdijes së publikut mbi rreziqet e korrupsionit, sensibilizimi i qytetarëve dhe bizneseve për rolin e tyre në zvogëlimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.
- Përmirësimi i raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në komunë.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve në sektorin publik dhe privat.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike si dhe forcimi i sundimit të ligjit.

5. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson ligjshmërinë e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i cenueshmërisë të identifikuar dhe të vlerësuar për të gjitha fushat e funksionimit të komunës.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar cenueshmërinë e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i cenueshmërisë së integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të komunës. Një pjesë e të punësuarve, kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të komunës dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

5.1 Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa fazave si në vijim:

- *Faza përgatitore* – përfshin themelimin e grupit punues dhe emërimin e koordinatorit për zhvillimin e planit të integritetit; mbledhjen e informacioneve të nevojshme për zhvillimin e planit të integritetit si dhe njoftimin e të gjithë punonjësve për rëndësinë e Planit të Integritetit.
- *Faza e vlerësimit të rrezikut të integritetit* – gjatë kësaj faze koordinatori së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionin e mbledhur (legjislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së komunës; përshkrimet e punës dhe fushëveprimin e çdo njësie komunale) si dhe çdo proces për vendimmarrje dhe ofrimin e shërbimeve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale përcaktohen fushat e rrezikut si dhe identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve.

- *Faza e përcaktimit të prioriteteve, dhe propozimit të masave për përmirësimin e integritetit* - kjo fazë përfshin përcaktimin e prioriteteve për intervenim, përcaktimin e masave për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve dhe përgjegjësit për zbatim
- *Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të integritetit* - përfshin monitorimin, vëzhgimin dhe regjistrimin e rregullt të aktiviteteve që ndodhin në një Plan të Integritetit dhe procesin e mbledhjes së informacionit për të gjitha aspektet e zbatimit të Planit të Integritetit. Ndërsa raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve për përmirësimin e zbatimit të Planit të Integritetit

5.1 Metodologjia e vlerësimit të rrezikut

Vlerësimi i rrezikut do të thotë renditja e rreziqeve më të mëdha në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e komunës dhe mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të komunës. Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj, prioritetet përcaktohen ashtu që resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku vërehet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, përputhen me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit. Në anën tjetër, rreziqet madhore kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masat adekuate.

Pas përcaktimit të dy parametrave, gjasave të ndodhjes së rrezikut dhe pasojave (ndikimit) të rrezikut të ndodhur, grupi punues duhet të përcaktojë nivelin e rrezikut për të gjitha rreziqet e identifikuar dhe të vlerësuara, duke përdorur Matricën e Rrezikut. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet bazuar në Matricën e Rrezikut si kombinim i gjasave dhe pasojave.

7.1.1 Matrica vlerësimit të rrezikut

Matrica e vlerësimit të rrezikut mundëson të llogaritet rreziku në një fushë, aktivitetet e komunës për një kohë shumë të shpejtë, duke identifikuar të gjitha gjërat që mund të shkojnë keq dhe duke peshuar dëmin e mundshëm. Kjo e bën më të lehtë prioritizimin e

çështjeve dhe ndërmarjen e veprimeve, masave aty ku është më e nevojshme për të mbajtur fushën, aktivitetin e komunës në rrugë të mbarë.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

| | | | | | | | | |
|-----------------------------|---|---|-------------|--|----------------|--|--|--------------|
| Pasoja /Ndikimi | Madhor | | | | | | | |
| | | | | | | | | |
| | Mesatar | 7 | | | | | | |
| | | 6 | | | | | | |
| | | 5 | | | | | | |
| | | 4 | | | | | | |
| | Vogël | 3 | | | | | | |
| | | 2 | | | | | | |
| | | 1 | | | | | | |
| | Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi) | | Ulët | | Mesatar | | | Lartë |
| Probabiliteti/Gjasat | | | | | | | | |

Intenziteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

7.1.2 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

| | | |
|-------------|----------------|--------------|
| Ulët | Mesatar | Lartë |
| 1 - 15 pikë | 16 - 48 | |

Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të dëmtimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

Rreziku me intensitet të lartë – Korrupsioni ose format e tjera të dëmtimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

6. Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të organizatës. Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në projektim ashtu edhe në funksionim, dhe se procedurat janë kuptuar si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e riskut kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësimet duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen. Raportimi i rregullt, siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të planit të integritetit, krijohen mekanizmat për monitorimin dhe raportimin për zbatimin e Planit të Integritetit, si në vijim:

1. Grupi punues- emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës dhe është përgjegjës për:

- promovimin e integritetit në Komunë dhe merr masa për të parandaluar korrupsionin konfliktin e interesit dhe format e tjera të sjelljeve jo etike;

- hartimin e draftit të Planit Komunal të Integritetit;

-përgatitjen e programit për hartimin e planit të integritetit;

-siguron që Plani i Integritetit të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi, standardet e punës. metodat e vlerësimit të integritetit dhe me metodat e riparimit;

-zhvillimin e një qasje sistematike, gjithëpërfshirëse dhe të integruar ndaj rreziqeve;

-propozimin e masave të nevojshme për eliminimin dhe parandalimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike,

Grupi punues mbaron mandatin pas hartimit të planit komunal për integritet. Kryetari i Komunës themelon grupin e ri punues varësisht nga vlerësimi i nevojave.

2. Koordinatorin për integritet — emërohet me vendim të Kryetarit të Komunës dhe është përgjegjës për:

- të përgatitur metodologjinë për monitorimin e Planit të Integritetit; --
- raportimin mbi zbatimin e Planit të Integritetit;
- të mbledhë dhe analizon dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me funksionimin e organeve të Komunës, i cili është baza për vlerësimin e rrezikut dhe zhvillimin e Planit të Integritetit;
- pranimin dhe rishikimin e informacionit për situatat, ndodhitë dhe veprimet për të cilat ekziston një besim i arsyeshëm se ato përfaqësojnë një mundësi për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, konfliktit të interesit dhe formave tjera të sjelljeve jo etike;
- përgatitë dhe shpërndan pyetëtorin si dhe zhvillon intervistat me stafin komunal, me qëllim të mbledhjes së informatave për hartimin e Planit të Integritetit;
- në bashkëpunim me të gjitha njësitë organizative, përgatit raportet për zbatimin e planit të integritetit;
- sigurimin e zbatimit, azhurnimit dhe vlerësimit në bazë të vazhdueshëm të Planit të Integritetit si dhe standardet, format dhe procedurat për të mbështetur Planit të Integritetit

harton raporte periodike për monitorimin e planit të integritetit dhe i raporton kryetarit.

Koordinatori. gjithashtu, mbështet grupin punues në hartimin dhe përgatitjen e raporteve për zbatimin e Planit të Integritetit,, Koordinator i rekomandon Kryetarit për takim me grupin punues sa herë që vlerësohet e nevojshme.

7. Fushat e rrezikut

7.1 Fushat e përgjithshme të Rrezikut

7.1.1 Drejtimi dhe menaxhimi

7.1.2 Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve

7.1.3 Planifikimi dhe menaxhimi financiar

7.1.4 Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve

7.2 Fushat e veçanta të rrezikut

7.2.1 Auditimi i Brendshëm

7.2.2 Prokurimi publik

7.2.3 Zhvillimi ekonomik lokal

7.2.4 Planifikimi urban dhe rural

7.2.5 Standardet e ndërtimit dhe kontrolli

7.2.6 Inspektimet

7.2.7 Arsimi Publik

7.2.8 Shëndeti publik

7.2.9 Licencimi i shërbimeve

7.2.10 Mirëmbajtja e rrugëve dhe e parqeve

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT

| Regjistrimi i rezikut | | Vlerësimi dhe matja e rezikut | | | Veprimi ndaj rezikut | | | | |
|-----------------------|-------------------------------|--|---|--------|----------------------|--|--|--|--------------------------------|
| Nr. | Fusha e rezikut | Përshkrimi i Rezikut | Masat ekzistues të kontrollit | Gjasat | Ndikimi | Vlerësimi | Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve | Njësia/zyrtari përgjegjës | Afati i realizimit |
| 1. | DREJTIMI DHE MENAXHIMI | Objektivat dhe prioritetet e zhvillimit të komunës të paqarta dhe jo transparente si dhe mos përfshirja e të gjitha fushave përkatëse për zhvillimin e komunës në Planin Zhvillimor. | Ligjet dhe aktet nënligjorë; Raportet periodike ; aktet e brendshme të komunës, Planin i Integritetit | 5 | | 45 | Zhvillimi i metodologjisë për hartimin e Planit Zhvillimor të komunës dhe zbatimin e saj. Sigurimi i pjesëmarrjes së përfqësuesve të të gjitha fushave përkatëse si dhe qytetarëve në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës | Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit, drejtuesit e organeve dhe drejtorive komunale | Deri në tremujorin e parë 2023 |
| | | Opinion publik negativ dhe humbja e besimit të publikut në punën e administratës komunale dhe Kuvendit Komunal për shkak të transparencës së pamjaftueshme | 3 | | 24 | Përditësimi i informatave në ueb faqen e Komunës për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e komunës Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me procedurat për hartimin dhe miratimin e akteve me interes publik me qëllim të përfshirjes së tyre në vendimmarrje | Kryetari i Komunës, Kryetari i Kuvendit dhe drejtuesit e drejtorive komunale | Në vazhdimësi | |

| | | | | | | | | | |
|----|--|--|---|---|---|----|---|---|---|
| 2. | POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË | Mospërputhja dhe paqartësia e përgjegjësive në administratën komunale | Ligjet, aktet nënligjor e; dhe aktet e brendshme të komunës | 4 | 5 | 24 | Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. | Kryetari i komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit dhe udhëheqësit sektorëve | Deri në tremujorin e tretë 2023 |
| | | Mos përcaktimi i qartë i përgjegjësive për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planit të Integritetit | | | | | Të përcaktohen përgjegjësitë sa i përket monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit të Integritetit | Kryetari i Komunës dhe drejtuesit e organeve komunale | Pas miratimit të Planit të Integritetit |
| 2. | POLITIKA E BURIMEVE NJERËZORE, SJELLJA ETIKE DHE PROFESIONALE E TË | Mos monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Planit të Integritetit | Ligjet, aktet nënligjor e; dhe aktet e brendshme të komunës | 4 | 5 | 32 | Të monitorohet dhe raportohet rregullisht zbatimi i Planit të Integritetit | Mekanismat përkatës të përcaktuara me vendim të Kryetarit të komunës | Çdo tre muaj |
| | | Mos plotësimi i vendeve të punës me staf adekuat dhe të mjaftueshëm | | | | | Të rishikohet niveli i zbatimit dhe të përditësohen masat për përmirësimet. | Menaxheri i integritetit, Koordinatori dhe Grupi Punues i integritetit. | Çdo gjashtë muaj |
| | | Profesionalizimi dhe kompetenca e të punësuarve. | | | | | Zhvillimi dhe miratimi i Planit të Personelit | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit dhe drejtorive | Dhjetor të çdo viti |
| | | | | | | 40 | Zbatimi i parimit të meritës gjatë procedurave të punësimit | Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit dhe drejtorive | Në vazhdimësi |

| PUNËSUARV E | | | | | | | | | |
|--|---|--|---|---|---------------------------------|--|--|--|--|
| Përshkrimet e vendeve të punës të nëpunësve të pa qarta, jo adekuate dhe të pa përditësuara | 4 | 32 | Të bëhet analiza e nevojave për trajnime | Njësia e Burimeve Njerëzore, | Deri në tremujorin e tretë 2023 | | | | |
| | | | Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarave | drejtuesit e drejtorive | | | | | |
| Mungesa e kodit komunal të etikës për gjithë zyrtarët komunal përfishirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit. | 7 | Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura | Të harmonizohen përshkrimet e vendeve të punës me proceset dhe procedurat përkatëse të punës. | Kryetari i Komunës dhe Kuvendit, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit drejtorive udhëheqësit e sektorëve | Dhjetor 2023 | | | | |
| | | Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për gjithë zyrtarët komunal përfishirë zyrtarët publik dhe të zgjedhurit dhe të emëruarit | | | | | | | |

| | | | | | | | | |
|----|--|---|--|---------------|----------------------------------|--|--|---|
| 4. | RUAJTJA DHE SIGURIA E TË DHËNAVE DHE DOKUMENTACIONIT | Siguria e pamjaftueshme e të dhënave në sistemet e teknologjisë informative si dhe përdorimi i tyre për qëllime jozyrtare | Ligjet, aktet nënligjor e; dhe aktet e brendshme të komunës. | 4 | 7 | me të komunës | Shpenzimi i buxhetit jo në mënyrë adekuate dhe jo mjaftueshëm transparent | Inventarizimi dhe regjistrimi joefikas i asetëve komunale |
| | | | | | | | | |
| 36 | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative | Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rezikut nga mashtrimet dhe | Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK | Në vazhdimësi | Pas aprovimit të buxhetit vjetor | Kryetari i Komunës dhe drejtorja për buxhet dhe financa | Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve | |
| | | | | | | | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore. | |
| | | | | | | | Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e komunës | |
| | | | | | | | Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit duke krijuar një komision të përbërë nga përfaqësuesit e komunës dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit. | |
| 36 | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative | Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rezikut nga mashtrimet dhe | Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK | Në vazhdimësi | Pas aprovimit të buxhetit vjetor | Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit | | |
| | | | | | | Të përditesohet regjistri i brendshëm i asetëve të komunës | | |
| | | | | | | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | | |
| 36 | Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative | Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rezikut nga mashtrimet dhe | Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK | Në vazhdimësi | Pas aprovimit të buxhetit vjetor | Drejtoria për Buxhet dhe Financa | | |
| | | | | | | Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës dhe sektori i TIK | | |

| | | | | | | | | | |
|----|---|---|---|---|----|---|---|---|---------------|
| 2. | PROKURIMI PUBLIK | Mungesa mbikëqyrjes adekuate, profesionale zbatimin e rekomandimeve | e | Ligjet, aktet nënligjor e; dhe aktet e brendshme të komunës | 3 | 27 | Zhvillimi i një plani për zbatimin e rekomandimeve të auditimit | Kryetari i Komunës, drejtorët dhe drejtorive | Në vazhdimësi |
| | | Mungesa e koordinimit ndërmjet Njësive të AB, Komisionit të Auditimit dhe Kryetarit | | | 3 | | Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit | Drejtorët dhe drejtorive | Në vazhdimësi |
| 6 | Përgatitje joefikase të specifikimeve të tenderit | e | Ligjet, aktet nënligjor e; dhe aktet e brendshme të komunës | 3 | 24 | Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njësive së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale. | Kryetari i Komunës, Njësia e AB, Komisioni i Auditimit | Në vazhdimësi | |
| | | | | Mos transparenca dhe mbikëqyrja e pa mjaftueshme e prokurimit publik | | 3 | Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit duke marrë parasysh kriteret për mos-diskriminim dhe duke siguruar qasje të barabartë | Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| 24 | Publikimi i Planit të Prokurimit në ueb faqen e komunës | e | Ligjet, aktet nënligjor e; dhe aktet e brendshme të komunës | 3 | 24 | Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për prokurimin publik | Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi | |
| | | | | Të caktohen auditime pas prokurimit dhe dhënies së kontratës për tenderë për të rishikuar respektimin e | | Kryetari i Komunës, Njësia e Auditimit të Brendshëm. | Në vazhdimësi | | |

| | | | | | | | | |
|----|---------------------------------------|---|---|---|----|--|---|----------------------------------|
| | | | | | | standardëve të specifikuara procedurale | | |
| | | | | | | Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin me ofertuesit dhe duke krijuar pika të qarta të kontaktit | Kryetari i Komunës dhe Njësia e prokurimit | Deri në tremujorin e parë 2023 |
| | | | 7 | | | Trajnimi i personelit për menaxhimin e kontratave/projektit | Njësia e prokurimit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| | | | 4 | | | Hartimi, rishikimi dhe përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës | Kryetari i Komunës, Drejtorja për Zhvillim Ekonomik | Deri në tremujorin e katërt 2023 |
| | | | 6 | | | Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës | Kryetari i Komunës, Drejtorja për Zhvillim Ekonomik | Deri në tremujorin e katërt 2023 |
| 3. | ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL DHE BUJQËSIA | Mungesa apo mos rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik lokal dhe Qëllimet dhe prioritetet e zhvillimit ekonomik të komunës të pagarta dhe jo-transparente. | Ligjet, aktet nënligjor e; dhe aktet e brendshme të komunës | 4 | 36 | | | |

| | | | | | | | | | |
|----|---|--|--|---|----|--|---|--|---------------|
| 5. | STANDARD ET NDËRTIMIT DHE KONTROLLI | Zbatim jo i plotë i rregullatIVES brendshme që lidhen me fushën e planifikimit urban dhe rural | dhe planet rregullati ve urbane | 5 | 45 | parandalojnë vendimet subjektive | Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullatIVES së brendshme | Drejtoria Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Njësia e Burimeve Njerëzore | Në vazhdimësi |
| | | Kualifikimi i pamjaftueshëm i personelit për hartimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të dokumenteve për planifikim urban dhe rural | | 3 | 27 | Të sigurohet personeli adekuat profesional për planifikim urban dhe rural | Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural | | |
| | | Mbikëqyrja jo efektive mbi zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural | | 5 | 40 | Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural | Kryetari i Komunës, Drejtoria Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | | |
| | | Mungesa e kontrolleve konsistente ndërtimit (vend punishtët) | Ligjet, aktet nënligjor e; aktet e brendshme të komunës dhe planet | 7 | | Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje. | Kryetari i Komunës, Drejtoria Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Në vazhdimësi | |
| | | Mungesë e stafit adekuat për kontrollimin ndërtimeve | | 3 | 30 | Të sigurohet personeli adekuat profesional për planifikim urban dhe rural | Drejtoria Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit | Deri në tremujorin e dytë 2023 | |

